

Reverence for Sacred Things

By Elder Ulisses Soares
Of the Quorum of the Twelve Apostles

Nderim për Gjërat e Shenjta

Nga Plaku Ulises Soares,
i Kuoromit të Dymbëdhjetë Apostujve

April 2025 general conference

Reverence for the sacred fosters genuine gratitude, expands true happiness, leads our minds to revelation, and brings greater joy to our lives.

In the book of Exodus, we travel with Moses to the slopes of Mount Horeb as he turned aside from his daily cares—something we all should be willing to do—to see the burning bush that was not consumed. As he approached, “God called unto him out of the midst of the bush, and said, Moses, Moses. And he said, Here am I. And [God] said, ... put off thy shoes from off thy feet, for the place whereon thou standest is holy ground.” In great reverence, humility, and wonder, Moses removed his shoes and prepared himself to hear the word of the Lord and to experience His holy presence.

That sacred mountain epiphany was an experience filled with awe-inspiring reverence, connected Moses to his divine identity, and was, in fact, a key element of his transformation from a humble shepherd to a powerful prophet, leading him to walk a new path in life. Similarly, each of us can transform our discipleship into a higher pattern of spirituality by making the virtue of reverence a sacred part of our spiritual character.

The word reverence can be traced to the Latin *verbrevereri*, which means to “stand in awe of.” In the gospel sense, this definition mingles with a feeling or attitude of profound respect, love, and gratitude. Such expression for the sacred by those who have a contrite heart and deep devotion to God and Jesus Christ fosters increased joy in their souls.

Nderimi për të shenjtën kultivon mirënjohje të çiltër, e rrit lumturinë e vërtetë, na e drejton mendjen te zbulesa dhe na sjell gëzim më të madh në jetë.

Në librin e Eksodit, ne udhëtojmë bashkë me Moisiun drejt shpateve të malit të Horebit, teksa ai i lë mënjane punët e përditshme – diçka që të gjithë ne duhet të jemi të gatshëm ta bëjmë – për të parë ferrishtën që digjej nga zjarri, por nuk bëhej shkrumb. Kur u afrua, “Perëndia e thirri nga mesi i ferrisht[ë]s dhe i tha: ‘Moisi, Moisi!’ Ai u përgjigj: ‘Ja ku jam’. Perëndia tha: ‘... Hiq sandalet nga këmbët, sepse vendi në të cilin ndodhesh është vend i shenjtë.’” Me nderim, përlësi dhe mahnitje të madhe, Moisiu i hoqi këpucët dhe u bë gati të dëgjonte fjalën e Zotit dhe të përjetonte praninë e Tij të shenjtë.

Ai manifestim i shenjtë në mal, një përvojë e mbushur me nderim mahnitës, e lidhi Moisiun me identitetin e tij hyjnor dhe që, në fakt, një element kyç i shndërrimit të tij nga një bari i përlur në një profet të fuqishëm, duke e drejtuar të merrte një rrugë të re në jetë. Në mënyrë të ngjashme, secili prej nesh mund ta shndërrojë dishepullimin e vet në një model më të lartë shpirtshmërie duke e bërë virtytin e nderimit një pjesë të shenjtë të karakterit tonë shpirtëror.

Fjalanderim [“reverence”] [në anglisht] mund ta ketë origjinën nga folja latin *revereri*, që do të thotë “mahnitem nga”. Në kuptimin ungjillor, ky përkufizim përfshin gjithashtu një qëndrim apo ndjenjë respekti, dashurie dhe mirënjohjeje të thellë. Një shprehje e këtillë për të shenjtën nga ata që kanë një zemër të penduar dhe përkushtim të thellë ndaj Perëndisë dhe Jezu Krishtit kultivon një ndjenjë të shtuar gëzimi në shpirtin e tyre.

Reverence for sacred things is the greatest manifestation of a vital spiritual quality; it is a by-product of our connection to holiness and reflects our love for and proximity to our Heavenly Father and our Savior, Jesus Christ. It is also one of the most elevated experiences of the soul. Such virtue directs our thoughts, hearts, and lives toward Deity. In fact, reverence is not just an aspect of spirituality; it is the essence of it—the foundation upon which spirituality is built, creating a personal connection to the divine, as taught by our children when they sing, “When I am rev’rent, I know in my heart Heav’nly Father and Jesus are near.”

As disciples of Jesus Christ, we are invited to cultivate the gift of reverence in our lives in order to open ourselves to a deeper communion with God and His Son, Jesus Christ, simultaneously strengthening our spiritual character. Had we more of such feelings in our hearts, there would be undoubtedly greater joy and delight in our lives, and there would be less room for sorrow and sadness. We must remember that showing reverence for sacred things gives meaning to much of what we do every day and strengthens our feeling of gratitude—inspiring awe, respect, and love for higher and holier things.

Unfortunately, we live in a world where showing reverence for sacred things is becoming increasingly uncommon. In fact, the world celebrates the irreverent, as any perusal of a tabloid magazine, television program, or the internet attests. The absence of respect for the sacred produces an increasing casualness in attitude and carelessness in conduct, which can rapidly spiral one generation into apathy and catapult the next generation into misery.

Irreverence can also lead us away from the bonds that covenants with God provide and diminish our sense of accountability before Deity. Consequently, we run the risk of caring only about our own comfort; satisfying our uncontrolled appetites; and ultimately arriving to the unholy place of despising sacred things, even God, and consequently our divine nature as children of Heavenly Father. Irreverence toward sacred things furthers the adversary’s aims by disrupting our sensitive channels of revelation,

Nderimi për gjërat e shenjta është shfaqja më e madhe e një cilësie shpirtërore jetike; ai është rezultat i lidhjes që kemi me shenjtërinë dhe reflekton dashurinë për Atin tonë Qiellor dhe Shpëtimtarin tonë, Jezu Krishtin, si dhe afërsinë tonë me Ta. Nderimi është gjithashtu një nga përvojat më të shenjta të shpirtit. Një virtyt i tillë na i drejton mendimet, zemrën dhe jetën drejt Hyjnisë. Në fakt, nderimi nuk është thjesht një aspekt i shpirtshmërisë, ai është thelbi i saj, themeli mbi të cilën ndërtohet shpirtshmëria, duke krijuar një lidhje të vetën me hyjnore, siç na mësohet nga fëmijët tanë kur këndojnë: “Dhe kur jam plot nderim, në zemër e di, Ati Qiellor, Jezusi jan’ pran”.

Si dishepuj të Jezu Krishtit, ne jemi ftuar të kultivojmë dhuratën e nderimit në jetën tonë që të bëhemi më të hapur për një komunikim më të thellë me Perëndinë dhe Birin e Tij, Jezu Krishtin, duke forcuar njëkohësisht karakterin tonë shpirtëror. Nëse do të kishim më shumë ndjenja të tilla në zemër, pa dyshim që do të kishte më shumë gëzim dhe kënaqësi në jetën tonë, dhe do të kishte më pak vend për pikëllim e trishtim. Duhet të mbajmë mend se të treguarit nderim për gjërat e shenjta u jep kuptim shumë prej gjërave që bëjmë çdo ditë dhe na e forcon ndjenjën e mirënjohjes, duke frymëzuar mahnitje, respekt e dashuri për gjëra më të larta e më të shenjta.

Për fat të keq, ne jetojmë në një botë ku të treguarit nderim për gjërat e shenjta po bëhet gjithnjë e më i pazakontë. Në fakt, bota kremton atë që nuk është nderuese, siç dëshmon çdo shqyrtim i një reviste me tituj të bujshëm, i një programi televiziv apo i internetit. Mungesa e respektit për të shenjtën prodhon gjithnjë e më shumë shkujdesje në qëndrim dhe pakujdesi në sjellje, që mund ta bëjnë një brez të bjerë me shpejtësi në vorbullën e plogështisë dhe ta hedhë si me katapultë brezin e ardhshëm në mjerim.

Mungesa e nderimit gjithashtu mund të na largojë prej lidhjeve që ofrojnë besëlidhjet me Perëndinë dhe ta zvogëlojë ndjenjën tonë të përgjegjësisë para Hyjnisë. Rrjedhimisht, rrezikojmë që të kujdesemi vetëm për rehatinë tonë vetjake, të kënaqim orekset tona të pakontrolluara dhe përfundimisht të mbërrijmë në pikën e paudhë të përbuzjes së gjërave të shenjta, madje të Perëndisë, e rrjedhimisht të natyrës sonë hyjnore si fëmijë të Atit Qiellor. Mungesa e nderimit për gjërat e shenjta i bën synimet e kundërshtarit të

which are crucial for our spiritual survival in our day.

The meaning and importance of reverence for what is sacred is well outlined throughout the scriptures. One instance in the Doctrine and Covenants would seem to indicate that reverence toward our Heavenly Father and His Son, Jesus Christ, is an essential virtue for those who attain the celestial kingdom.

As a church we strive to hold the Father and the Son in the utmost sacredness and respect in every aspect, including how we depict Their images. The guidance of the Holy Ghost is a crucial component in determining how these images should reflect the sacred nature, character, and godly attributes of the Father and of the Son. We are very careful to avoid portraying elements that could distract from our primary focus on our Heavenly Father and His Son, Jesus Christ, and Their teachings, including how we apply advanced tools offered by technology, such as using artificial intelligence (AI) to generate content and images.

This same principle is applied to any source of information available through the official communication channels of the Church. Every lesson, book, manual, and message is carefully developed and approved under the direction of the Spirit to make sure we maintain the sacred virtue, values, and standards of the gospel of Jesus Christ. In a recent message for the young adults of the Church, Elder David A. Bednar taught, “To navigate the complex intersection of spirituality and technology, Latter-day Saints should humbly and prayerfully (1) identify gospel principles that can guide their use of artificial intelligence and (2) strive sincerely for the companionship of the Holy Ghost and the spiritual gift of revelation.”

My dear brothers and sisters, as sophisticated as modern technology has become, it simply cannot simulate the wonder, awe, and amazement found in the kind of reverence born from the influence of the Holy Ghost. As followers of Christ, we need to be careful not to weaken our connection with God and His Son by using AI-generated content and images inappropriate-

përparojnë duke i bllokuar kanalet tona delikate të zbulesës, të cilat janë thelbësore për mbijetesën tonë shpirtërore në këtë kohë.

Kuptimi dhe rëndësia e nderimit për atë që është e shenjtë është përvijuar mirë kudo në shkrimet e shenjta. Një rast në librin Doktrina e Besëlidhje duket se sugjeron që nderimi ndaj Atit tonë Qiellor dhe Birit të Tij, Jezu Krishtit, është një virtyt thelbësor për njerëzit që e arrijnë mbretërinë çelestiale.

Si Kishë, ne përpiqemi fort t'i shohim Atin dhe Birin me shenjtërinë dhe respektin maksimal në çdo aspekt, duke përfshirë mënyrën se si i paraqesim figurat e Tyre. Udhërrëfimi i Frymës së Shenjtë është një komponent thelbësor në përcaktimin se si këto figura duhet të pasqyrojnë natyrën e shenjtë, karakterin dhe cilësitë e përendishme të Atit dhe të Birit. Ne tregohemi shumë të kujdesshëm për të shmangur portretizimin e elementeve që mund të shpërqendrojnë nga përqendrimi ynë parësor që është tek Ati ynë Qiellor dhe Biri i Tij, Jezu Krishti, dhe mësimet e Tyre, përfshirë mënyrën se si i vëmë në zbatim mjetet e përparuar që ofron teknologjia, të tilla si shfrytëzimin e inteligjencës artificiale (IA) për të krijuar përmbajtje dhe figurat.

Po ky parim zbatohet për çdo burim informacioni që është në dispozicion përmes kanaleve zyrtare të komunikimit të Kishës. Çdo mësim, libër, manual dhe mesazh hartohet e miratohet me kujdes nën drejtimin e Shpirtit për t'u siguruar që të ruajmë virtytin, vlerat dhe standardet e shenjta të ungjillit të Jezu Krishtit. Në një mesazh të kohëve të fundit për të rinjtë e të rejat në moshë madhore të Kishës, Plaku David A. Bednar dha mësim: “Për të lundruar në kryqëzimin e ndërlikuar të shpirtshmërisë me teknologji[n]ë, shenjtorët e ditëve të mëvonshme duhet që me përlësi e plot lutje 1) të përcaktojnë parimet e ungjillit që mund të udhërrëfejnë përdorimin prej tyre të inteligjencës artificiale, dhe 2) të përpiqen fort sinqerisht për shoqërimin e Frymës së Shenjtë dhe dhuratën shpirtërore të zbulesës”.

Vëllezërit dhe motrat e mia të dashura, sado e zhvilluar të jetë bërë teknologjia moderne, ajo thjesht nuk mundet ta imitojë mrekullinë, mahnitjen dhe habinë që gjendet në atë lloj nderimi që lind nga ndikimi i Frymës së Shenjtë. Si ndjekës të Krishtit nevojitet të jemi të kujdesshëm që të mos e dobësojmë lidhjen tonë me Perëndinë dhe Birin e Tij duke i përdorur në

ly. We should remember that relying on a modern technological “arm of flesh” is an inadequate and disrespectful substitute for the inspiration, edification, and witness that can be received only through the power of the Holy Ghost. As Nephi declared: “O Lord, I have trusted in thee, and I will trust in thee forever. I will not put my trust in the arm of flesh.”

In another revelation, the Prophet Joseph Smith was instructed that temples erected unto the Lord should be a place of reverence to Him. Throughout his ministry, our dear prophet, President Russell M. Nelson, has strongly emphasized our worship in reverence in the sacred temple. In the house of the Lord, we are taught about entering into the holy presence of the Father and the Son. I have always found it instructive and even inspiring that one of the first things we do upon entering the temple and preparing ourselves to participate in the sacred ordinances there is to remove our shoes and change into our white clothing. Like Moses, if we are intentional, we can recognize that taking off our worldly shoes is the beginning of stepping onto holy ground and being transformed in higher and holier ways.

Brothers and sisters, we do not need to climb to the top of a mountain, like Moses did, to discover reverence for sacred things and convert our discipleship into a deeper level of spirituality and devotion. We can find it, for example, as we strive to protect our home environment from worldly influences. This can be accomplished by sincerely and fervently praying before our Heavenly Father in the name of Jesus Christ and seeking to better know our Savior through our diligent study of the word of God found in the scriptures and in the teachings of our prophets. Additionally, such spiritual transformation can come as we strive to honor the covenants we have made with the Lord by living in obedience to the commandments. These efforts can bring a quiet and certain stillness to our hearts. Focusing on such actions can surely help transform our homes into reverent places of spiritual refuge—personal sanctuaries of faith where the Spirit resides, much like the mountain experience of Moses.

mënyrë të papërshtatshme përmbajtjen dhe figurat e krijuara nga IA-ja. Duhet të mbajmë mend se mbështetja në “krahun [teknologjik, modern] prej mishi” është një zëvendësues i papërshtatshëm dhe i parespektueshëm për frymëzimin, lartësimin moral dhe dëshminë që mund të merren vetëm përmes fuqisë së Frymës së Shenjtë. Sikurse shpalli Nefi: “O Zot, unë kam besuar te ti dhe unë do të besoj te ti përgjithmonë. Unë nuk do ta vë besimin tim në krahun prej mishi.”

Në një zbulesë tjetër, Profeti Jozef Smith u udhëzua që tempujt e ngritur për Zotin duhet të jenë një vend nderimi për Të. Gjatë gjithë shërbesës së tij, profeti ynë i dashur, Presidenti Rasëll M. Nelson, e ka vënë fuqimisht theksin tek adhurimi ynë me nderim në tempullin e shenjtë. Në shtëpinë e Zotit ne marrim mësim për hyrjen në praninë e shenjtë të Atit dhe Birit. Gjithmonë më është dukur diçka edukative dhe madje frymëzuese që një nga gjërat e para që bëjmë kur hyjmë në tempull dhe bëhemi gati për të marrë pjesë në ordinancat e shenjta atje, është që heqim këpucët dhe ndërrohem i vishemi me veshjet tona të bardha. Ashtu si Moisiu, nëse jemi qëllimplotë, ne mund ta kuptojmë se heqja e këpucëve të kësaj bote është fillimi i hyrjes në tokë të shenjtë dhe i shndërrimit tonë në mënyra më të larta dhe më të shenjta.

Vëllezër e motra, nuk kemi nevojë të ngjitemi në majë të një mali, siç bëri Moisiu, për të zbuluar nderimin për gjërat e shenjta dhe për ta kthyer dishepullimin tonë në një nivel më të thellë shpirtshmërie dhe përkushtimi. Ne mund ta gjejmë atë, për shembull, kur përpiqemi fort ta mbrojmë mjedisin tonë familjar nga ndikimet e botës. Kjo mund të arrihet duke u lutur me çiltërsi dhe zjarr para Atit tonë Qiejlor në emër të Jezu Krishtit dhe duke u përpjekur ta njohim më mirë Shpëtimtarin tonë nëpërmjet studimit tonë me zell të fjalës së Perëndisë që gjendet në shkrimet e shenjta dhe në mësimet e profetëve tanë. Përveç kësaj, një shndërrim i tillë shpirtëror mund të vijë kur përpiqemi fort t'i nderojmë besëlidhjet që kemi bërë me Zotin duke jetuar me bindje ndaj urdhërimeve. Këto përpjekje mund të na sjellin një qetësi të heshtur dhe të sigurt në zemër. Përqendrimi në veprime të tilla sigurisht që mund të ndihmojë për t'i shndërruar shtëpitë tona në vendstrehime shpirtërore plot nderim, në shenjtërore vetjake të besimit, ku banojnë shpirti, në ngjashmëri të madhe me përvojën e Moisiut në mal.

We can also experience such spiritual transformation as we faithfully participate in the Church's worship service, including tuning our hearts to the Lord through our sincere singing of sacred hymns. Turning aside—like Moses—from worldly distractions, especially our cell phones or anything not in harmony with this sacred moment, enables us to turn our full attention to partaking of the sacrament, with our minds and hearts focused on the Savior and His atoning sacrifice along with our own covenants. Such sacramental focus will foster a reverently renewing moment of our communion with the Savior and will make the Sabbath a delight and transform our life.

Ultimately, we can experience this spiritual change in our discipleship as we regularly worship in the mountain of the Lord's house—our holy temples—and strive to live with covenant confidence, especially when we face the trials of mortal life.

My wife and I have personally experienced some sacred mountain moments in reverence as we have strived to apply these principles in our life, which has caused a meaningful transformation in our discipleship. I remember like it was yesterday walking through the cemetery before burying our second child, who was born prematurely and did not survive, while my wife was still recovering in the hospital. I recall praying to God with great fervency and reverence, asking for help to cope with that challenging trial. In that instant, I received a clear and powerful spiritual assurance in my heart: Everything will be fine in our lives if my wife and I endure, holding on to the joy that comes from living the gospel of Jesus Christ. What seemed like an overwhelming, sorrowful challenge at the time turned into a sacred, reverent experience, a capstone that has helped sustain our faith and has given us confidence in the covenants we have made with the Lord and in His promises for me and my family.

My brothers and sisters, reverence for the sacred fosters genuine gratitude, expands true happiness, leads our minds to revelation, and brings greater joy to our lives. It places our feet on holy ground and lifts our hearts to Deity.

Ne gjithashtu mund të përjetojmë një shndërrim të tillë shpirtëror kur marrim pjesë besnikërisht në shërbesën e adhurimit në Kishë, përfshirë harmonizimin e zemrave me Zotin nëpërmjet të kënduarit me çiltërsi të himneve të shenjta. Mënjanimi, sikurse bëri Moisiu, nga shpërqendrimet e kësaj bote, veçanërisht nga celularët tanë apo çdo gjë që nuk është në harmoni me atë çast të shenjtë, na mundëson t'i kushtojmë vëmendje të plotë marrjes së sakramentit, me mendjen dhe zemrën e përqendruar te Shpëtimtari dhe flijimi i Tij shlyes, krahas besëlidhjeve tona vetjake. Një përqendrim i tillë te sakramenti do të nxitë një çast përtëritjeje dhe nderues në komunikimin tonë me Shpëtimtarin, do ta bëjë Shabatin një kënaqësi dhe do ta shndërrojë jetën tonë.

Përfundimisht, ne mund ta përjetojmë këtë ndryshim shpirtëror në dishepullimin tonë ndërsa adhurojmë rregullisht në malin e shtëpisë së Zotit – në tempujt tanë të shenjtë – dhe përpiqemi fort të jetojmë me vetëbesimin që vjen nga besëlidhjet, veçanërisht kur përballemi me sprovat e jetës në vdekshmëri.

Unë dhe bashkëshortja ime i kemi përjetuar personalisht disa çaste të shenjta në atë mal duke treguar nderim ndërsa jemi përpjekur fort t'i zbatojmë këto parime në jetën tonë, gjë që ka sjellë një shndërrim domethënës në dishepullimin tonë. Më kujtohet si të ishte dje ecja përmes varrezës para se të varrosnim fëmijën tonë të dytë, i cili lindi para kohe dhe nuk mbijetoi, ndërkohë që bashkëshortja ime ende po merrte veten në spital. Më kujtohet që iu luta me zjarr e nderim të madh Perëndisë, duke kërkuar ndihmë për t'u përballur me atë sprovë sfiduese. Në atë çast, m'u dha një siguri i qartë e i fuqishëm shpirtëror në zemër: Gjithçka do të jetë mirë në jetën tonë nëse unë dhe bashkëshortja ime durojmë, duke u mbajtur fort te gëzimi që vjen nga të jetuarit e ungjillit të Jezu Krishtit. Ajo që asokohe u duk si një sfidë mbisunduese dhe pikëlluese, u kthye në një përvojë të shenjtë e nderuese, një gur kulmor që ka ndihmuar për ta mbajtur fort besimin tonë dhe na ka dhënë vetëbesim në besëlidhjet që kemi bërë me Zotin dhe në premtimet e Tij për mua dhe familjen time.

Vëllezërit dhe motrat e mia, nderimi për të shenjtën kultivon mirënjohje të çiltër, e shton lumturinë e vërtetë, na e drejton mendjen te zbulesa dhe na sjell gëzim më të madh në jetë. Ai na i ngulit këmbët në tokë të shenjtë dhe na e

I testify to you that as we strive to incorporate such virtue into our daily lives, we will be able to increase our humility, expand our understanding of God's will for us, and strengthen our confidence in the promises of the covenants we have made with the Lord. I witness that as we embrace this gift of reverence for sacred things—whether in the mountain of the Lord's house, in a meetinghouse, or in our own homes—we will be filled with astounding amazement and awe as we connect to the perfect love of our Heavenly Father and Jesus Christ. I reverently witness these truths in the sacred name of our Savior and Redeemer, Jesus Christ, amen.

ngre zemrën drejt Hyjnisë.

Ju dëshmoj se ndërsa përpiqemi fort ta përfshijmë një virtut të këtillë në jetën tonë të përditshme, ne do të jemi në gjendje ta bëjmë më të madhe përlësinë tonë, ta zgjerojmë kuptueshmërinë tonë për vullnetin që Perëndia ka për ne dhe ta forcojmë mirëbesimin në premtimet e besëlidhjeve që kemi bërë me Zotin. Dëshmoj se ndërsa e përqafojmë këtë dhuratë të nderimit për gjërat e shenjta – qoftë në malin e shtëpisë së Zotit, në një shtëpi mbledhjesh apo në vetë shtëpinë tonë – ne do të mbushemi me habi dhe mahnitje të mrekullueshme ndërsa krijojmë lidhje me dashurinë e përsosur të Atit tonë Qiejllor dhe Jezu Krishtit. Dëshmoj me nderim për këto të vërteta në emrin e shenjtë të Shpëtimtarit dhe Shëlbuesit tonë, Jezu Krishtit, amen.